



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.04.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

1.2 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

1.3 Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

1.4 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:39 dhe mbaroi në orën 14:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
2. *Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

1.2 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

1.3 Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

1.4 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ilir Rusi: Përhëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë me e-mail dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklarohet të hapur mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 28.04.2023, ora 14:30, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

1.1. Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile; 1.2. Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

1.3. Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

1.4. Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për të cilat është përgatitur relacioni përkatës.

Për më tej fjalën zotit Toro.

Dritan Hallunaj: Po, faleminderit Kryetar! Po e marrë fjalën unë, zoti Hallunaj.

Mund të vijoj?

Ilir Rusi: Po, zoti Hallunaj, po!

Dritan Hallunaj: Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 213, datë 28.04.2023, ka vendosur “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”.

Me vendimin nr. 214, datë 28.04.2023, KLGJ, ka vendosur “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”.

Me vendimin nr. 215, datë 28.04.2023, KLGJ, ka vendosur “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.”

Me vendimin nr. 216, datë 28.04.2023, KLGJ, ka vendosur “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në

gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.”

Për rrjedhojë Komisioni, referuar pikës 2 të vendimeve nr. 213, nr. 214, nr. 215 dhe nr. 216 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosi të njohë të drejtën e znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} për të zgjedhur për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht për:

znj. {...} – “Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

znj. {...} – Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

z. {...} – Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë,

znj. {...} – Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Më datë 28.04.2023, nëpërmjet postës elektronike Këshilli i është drejtuar gjyqtarës znj. {...} me “njoftim mbi të drejtën për të zgjedhur për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas pikës 2, të vendimit nr. 213, datë 28.04.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kthim përgjigjen nëpërmjet postës elektronike më datë 28.04.2023, gjyqtarja znj. {...} ka ushtruar të drejtën për të zgjedhur për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme, konkretisht në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në fushën e të drejtës civile.

Më datë 28.04.2023, nëpërmjet postës elektronike Këshilli i është drejtuar gjyqtarës znj. {...} me “njoftim mbi të drejtën për të zgjedhur për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas pikës 2, të vendimit nr. 214, datë 28.04.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kthim përgjigjen nëpërmjet postës elektronike më datë 28.04.2023, gjyqtarja

znj. {...} ka ushtruar të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme, konkretisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Më datë 28.04.2023, nëpërmjet postës elektronike Këshilli i është drejtuar gjyqtarit z. {...} me “njoftim mbi të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas pikës 2, të vendimit nr. 215, datë 28.04.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kthim përgjigjen nëpërmjet postës elektronike më datë 28.04.2023, gjyqtari z. {...} ka ushtruar të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme, konkretisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Më datë 28.04.2023, nëpërmjet postës elektronike Këshilli i është drejtuar gjyqtares znj. {...} me “njoftim mbi të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas pikës 2, të vendimit nr. 216, datë 28.04.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kthim përgjigjen nëpërmjet postës elektronike më datë 28.04.2023, gjyqtarja znj. {...} ka ushtruar të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme, konkretisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Pas shqyrtimit të shkresave kthim përgjigje, referuar ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme për gjyqtarët e sipërcituar, Komisioni vlerëson se procedura e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

Mbi sa më lart, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimet:

“Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”;

“Për transferimin e gjyqtares {...}, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”;

“Për transferimin e gjyqtarit {...} në një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

“Për transferimin e gjyqtarës {...} në një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

Projektvendimet janë të strukturuar në këto pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimeve propozohet transferimi i gjyqtarëve {...}, {...}, {...} dhe {...}, përkatësisht në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile; në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për shkak të suprimimit të pozicioneve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Përmet dhe Pukë ku kanë caktimin në mënyrë të përhershme.

Në pikën 2 të projektvendimeve përcaktohen efektet juridike të këtyre vendimeve, konkretisht më datë 01.05.2023.

Për znj. {...}, meqenëse Këshilli në vendimin nr. 217, datë 16.06.2022 ka përsëritur transferimin e përkohshëm të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri 1 vit, në kushtet kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë përfundon funksionimin në datë 30.04.2023, Këshilli duhet të shprehet lidhur me përfundimin para afatit të transferimit të saj.

Në projektvendimet respektive të gjyqtarëve {...} dhe {...} është parashikuar edhe mënyra e vijimit të çështjeve në gjykatat respektive Kavajë dhe Pukë; konkretisht ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër të caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë/Pukë dorëzohen menjëherë prej tyre.

Në pikën vijuese të projektvendimeve përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në pikën 4 të projektvendimeve përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, në projektvendime përcaktohet hyrja e tij në fuqi, konkretisht menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga zoti Hallunaj në lidhje me...?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse kemi të bëjmë me katër projekt-akte, po vazhdoj me votimin mbi projektvendimin e parë që ka të bëjë me gjyqtaren {...}.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. Përfundimin përpara afatit të transferimit me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.04.2023.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dorëzohen menjëherë prej saj.

5. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për sa u parashtrua nga relatori ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarës znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin “Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Për sa u parashtrua nga relatori zoti Hallunaj, ka diskutime nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.

3. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si në seancë paraprake ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dorëzohen menjëherë prej tij.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me projektvendimin në lidhje me transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Për sa u parashtrua nga relatori z. Hallunaj, ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me votimin e këtij projektvendimi, rendi i ditës është i ezauruar, kështu që mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Kalofshi mirë këto ditë pushimi.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor